



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Përkthim B-A

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 0 leksione / 40 seminare

Viti / Semestri: Viti III, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Kjo lëndë synon të aftësojë studentin në kontaktet e para me materialet në gjuhë të huaja të një shkalle vështirësie të mesme, të cilat përmes përdorimit të fjalorëve dhe konsultave në auditor do të arrijë të tejkalojë vështirësitë fillestare në përpjekjen e tij për të sjellë në gjuhën shqipe materialet e dhëna.

Objektivat specifike lëndore:

1. Aftësi për të fituar koncepte bashkëkohore të përkthimit.
2. Aftësi për të trajtuar situata të ndryshme të vështira.
3. Njohuri mbi faktet përkthimore dhe sjelljen e përkthyesit.
4. Aftësi për të shprehur mendime të vështira nga ana gjuhësore.
5. Aftësi për të punuar në ekip dhe për të bashkëpunuar me persona të tjerë.
6. Aftësi për të marrë vendime.

Rezultatet e pritshme:

1. Zbatojë koncepte themelore të përkthimit bashkëkohor, duke përdorur fjalorë dhe mjete ndihmëse për të përkthyer tekste me vështirësi të mesme nga gjuha e huaj në shqip.
2. Përballojë sfida përkthimore në mënyrë të argumentuar, duke marrë vendime të arsyetuara për përzgjedhjen e termave dhe strukturave gjuhësore të përshtatshme.
3. Shprehë me saktësi mendime komplekse në shqip, duke ruajtur qëllimin dhe stilin e tekstit burimor.
4. Bashkëpunojë në mënyrë efektive në punë grupi, duke kontribuar në zgjidhjen e problemeve gjuhësore dhe në procesin e përkthimit me kolegët.